



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

UP1 nr:0802-24

09.02.2024

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.0802-24 datë 23.01.2024 dhe Propozimi PA1 nr.0802-24 datë 05.02.2024 nga z. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe sipas Konkluzionit, ark.nr.0201-605/6 datë 0702.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 5-të mbajtur më 02.07.2024, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 4-të mbajtur më 25.01.2024, me Konkluzion, ark.nr.0201-399/6, datë 26.01.2024, miratoi propozimin PA1 nr.0802-24, datë 23.01.2024, për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, e parashtruar nga propozuesi dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437, datë 15.08.2016, për faktin se pas kryerjes së mbikëqyrjes së jashtëzakonshme administrative, në Raportin ark.nr.03-354/1 datë 18.01.2024, është konstatuar se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më 26.01.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.0802-24 datë 26.01.2024, me të cilën është njoftuar se nëse nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm nga i cili mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren e cituar, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio. Njoftimi PA1 nr.0802-24 datë 26.01.2024 i është dorëzuar SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar dhe është pranuar në rregull nga transmetuesi më 29.01.2024.

Më 01.02.2024 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për Planifikim Strategjik dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit, është dorëzuar Raport me shkrim për kontrollin të kryer të mbikëqyrjes administrative me ark.nr.0304- 577 /1 datë 01.02.2024, në të cilin



Agjencia për
shërbime mediatike
audio dhe audiovizive

rr. Maqedonia nr 3 8
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut

tel. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIORE
AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË MEDIAS AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

është konstatuar se SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, pas së cilës drejtori i ka dorëzuar Këshillit të Agjencisë Propozim me nr.0802-24 datë 05.02.2024 , për marrjen e vendimit për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016 .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.0802-24 datë 23.01.2024 dhe Propozimin PA1 nr. 0802-24 datë 05.02.2024 nga dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin me ark.nr.0201-605/6 datë 07.02.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 5-të mbajtur më 02.07.2024, ka ndërprerë procedurën e inicuar për heqjen e lejes PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016 të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.

Bazuar në sa më sipër u miratua vendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

¹ Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 248/18).